



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 43, datë 29.05.2020

PËR

MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA TË AMBJENTIT, ME VENDNDODHJE NË KATIN ZERO TË ISH REPARTIT TË URT-SË, ME NR. PASURIE 2/423, ZK 8513, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 251 M<sup>2</sup> (NGA KJO SIP. NDËRTIMI 201 M<sup>2</sup> DHE SIP. FUNKSIONALE. 50 M<sup>2</sup>), PRONË E BASHKISË DURRËS, PËR NJË AFAT 5 (PESË) VJET, NËPËRMJET PROCEDURËS SË KONKURRIMIT

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM-së Nr.536, datë 01.05.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Durrës”, i ndryshuar, VKM-së nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, nenit 801 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë “Për Qiranë” dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore në Bashkinë Durrës, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin për dhënien me qira të ambjentit, me vendndodhje në katin zero të ish repartit të URT-së, me nr. pasurie 2/423, ZK 8513, me sipërfaqe të përgjithshme 251 m<sup>2</sup> (nga kjo sipërfaqe ndërtimi 201 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe funksionale 50 m<sup>2</sup>), pronë e Bashkisë Durrës, për një afat 5 (pesë) vjet, nëpërmjet procedurës së konkurrimit.



2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria Ligjore, Sektori i Pronave Publike Dhe Menaxhimit Të Aseteve.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me date 29/ 05 / 2020**




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 433/prot.  
3

Durrës, më 03.06.2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



KËSHILLIT BASHKIAK ✓

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.43 datë 29.05.2020 Për miratimin e dhënies me qira të ambjentit, me vendndodhje në katin zero të ish repartit të URT-së, me nr. pasurie 2/423, zk 8513, me sipërfaqe të përgjithshme 251 m<sup>2</sup> (nga kjo sip. ndërtimi 201 m<sup>2</sup> dhe sip. funksionale. 50 m<sup>2</sup>), pronë e bashkisë Durrës, për një afat 5 (pesë) vjet, nëpërmjet procedurës së konkurrimit.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

